

Vendim nr. 219, datë 26.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 26.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (H) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **HEKTOR MAHMUTAJ**, përfaqësuar nga avokati Dritan Jahaj, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 62-2022-1170 (105), datë 11.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. 1015, datë 14.06.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2025-1361, datë 18.09.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 17, 27, 28, 29, 30, 31, 32, pika 2, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 2, 3, 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 4 i Protokollit nr. 7 të saj; neni 71/a i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 09.07.1997, rreth orës 16:00, në rrugën që lidh fshatrat Bejar dhe Kutë të rrethit të Mallakastrës, nga një makinë të tipit “Mercedes Benz”, e kuqe, pa targa, është hapur zjarr në drejtim të viktimës G.J., që kulloste bagëtitë, duke i shkaktuar vdekjen e menjëhershme. Gjatë rrugës nga fshati Bejar për në Kutë, përpara se të kryhej vrasja, mjeti ishte ndeshur me kamionin e drejtuar nga R.S., me të cilin udhëtonte edhe L.M., i cili ka identifikuar në makinë si pasagjer nipin e tij, kërkuesin, ndërkohë që 3 personat e tjerë që udhëtonin në makinë nuk u identifikuan.

2. Pas funeralit, shtetasi H.Sh., me porosi të shtetasit S.M., ka shkuar te banesa e të atit të viktimës për t’i thënë se djalin ia kishte vrarë djali i këtij të fundit, kërkuesi, fakt ky që është kallëzuar rreth dy muaj pas ngjarjes, në shtator të vitit 1997, nga i ati i viktimës F.J në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mallakastër. Nga ana e organit procedues është regjistruar procedimi penal nr. 49 i vitit 1997 në ngarkim të kërkuesit dhe, në përfundim të hetimeve, kërkuesi është akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vrasja me paramendim” dhe “Mbajtja pa leje e armëve të zjarrit”, të parashikuara nga nenet 78 dhe 25, si dhe 278, paragrafi 2, të Kodit Penal (KP). Që prej asaj kohe rezulton se kërkuesi është larguar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në Mbretërinë e Bashkuar, dhe nuk është kthyer asnjëherë. Për atë ngjarje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 146, datë 14.04.2000, ka vendosur deklarinim fajtor të kërkuesit për veprat penale të parashikuara nga nenet 78 dhe 25, si dhe 278, paragrafi 2, të KP-së dhe dënimin përfundimisht të tij me 25 vjet burg. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 24.04.2000.

3. Në vitin 2018, në zbatim të urdhrit të kërkimit ndërkombëtar, kërkuesi është arrestuar në Britaninë e Madhe ku jetonte dhe shteti shqiptar ka kërkuar ekstradimin e tij për të vuajtur dënimin, kundrejt garancisë për ta rigjykuar. Në datën 21.11.2018 kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesit të zgjedhur nga familjarët, ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 146, datë 14.04.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe kjo e fundit, me vendimin nr. 62-2018-6373 (2065), datë 05.12.2018, ka vendosur mospranimin e kërkesës, vendim ky i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 211, datë 09.04.2019, me argumentin se për sa kohë që ai nuk ishte ekstraduar nuk mund të kërkonte rigjykimin e tij. Ajo gjykatë ka konkluduar se 30 ditë pas ekstradimit kërkuesi mund të paraqiste kërkesë për rishikim.

4. Në datën 01.08.2020 kërkuesi është ekstraduar në shtetin shqiptar dhe në datën 31.08.2020 ai ka riparaqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier kërkesë për rishikimin e vendimit penal që e kishte dënuar në mungesë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin

nr. 62-2020-4019 (1333), datë 23.10.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe rishikimin e vendimit penal të formës së prerë nr. 146, datë 14.04.2000, nga një tjetër trup gjykues i asaj gjykate.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në rigjykim, me vendimin nr. 105, datë 11.03.2022, ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprave penale “Vrasja me paramendim”, të parashikuar nga nenet 78 dhe 25 të KP-së, si dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje të armëve luftarake dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 2, të KP-së, e dënimin e tij me një dënim të vetëm prej 25 vjetësh burgim. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuar, ndërsa Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka paraqitur apel kundërshtues, duke kërkuar miratimin e vendimit nr. 105, datë 11.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe mospranimin e shkaqeve të ankimit të pretenduara nga mbrojtja.

6. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 1015, datë 14.06.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 105, datë 11.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me ndryshimin e deklarinimit fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprës penale “Vrasja me dashje”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 76-25 të KP-së dhe dënimin përfundimisht me 21 vjet burgim. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe kërkuar. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-1361, datë 18.09.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, pasi nuk referon në shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

7. Në datën 02.04.2026 kërkuar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 14.04.2026.

II

Pretendimet e kërkuarit

8. **Kërkuar**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

8.1. *E drejta për një proces të rregullt gjyqësor në drejtim të:*

8.1.1. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit , si dhe së drejtës së mbrojtjes*, pasi gjykatat nuk kanë arsyetuar edhe mbi faktin se disa dëshmi referonin në persona të tretë, të cilët nuk ishin marrë kurrë në pyetje nga organi akuzës edhe pse nuk kishte pengesa objektive. Në pyetje nuk është marrë as shtetasi M.Sh. që sipas dëshmitarëve kishte dhënë emrat e personave që ndodheshin në makinë. Kërkuar nuk ishte njohur me kartën e të drejtave të tij në gjykatën e shkallës së parë,

ndërsa gjykata e apelit, në shkelje të ligjit, ka arsyetuar se fakti që ishte mbrojtur me avokat e kishte rregulluar këtë të metë të gjykimit. Në shkelje të nenit 378/a të KPP-së, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pas dhënies së konkluzioneve, revokoi vendimin për shpalljen e vendimit përfundimtar dhe riçeli hetimin pa kërkesë të asnjërës palë.

8.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi nga gjykatat nuk janë arsyetuar pretendimet për papërdorshmëri të provave për sa u takon deklarimeve të dëshmitarëve, pa i analizuar ato në raport me kriteret ligjore të nenit 154 të KPP-së dhe pa u shprehur se përse këto thënie të tërthorta konsideroheshin të përdorshme. Gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar as për mosadministrimin e dosjes nr. 49/1 që ishte procedim i ndarë për personat e tjerë të cilët ishin në makinë dhe që mund të përmbante prova vendimtare për zbardhjen e çështjes. Gjithashtu, gjykatat nuk kanë arsyetuar për deklarimet e dëshmitarëve për burimin e njohjes së faktit ku ekzistojnë tre versione kontradiktore mes tyre. Të gjitha shkeljet e pretenduara nga ai nuk janë korrigjuar as nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke mos përmbushur, kjo e fundit, funksionin e saj si gjykatë ligji.

8.2. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi dënimi i tij është mbështetur në një zinxhir indiciesh dhe thëniesh të tërthorta pa pasur asnjë provë shkencore, duke mos arritur një standard të lartë provueshmërie. Në rastin e tij, gjykatat e kanë bazuar vendimin në prova të tërthorta, pa burim të verifikuar, duke mos garantuar standardin e drejtësisë së procesit. Ndër të tjera, vendimet e dënimit janë dhënë në mungesë të këqyrjes së vendit të ngjarjes, këqyrjes së kufomës dhe aktekspertimit mjeko-ligjor, ekspertimit balistik dhe mosgjetjes së armës së krimit, mosqenies së asnjë dëshmitari në vendin e ngjarjes, ndërkohë që edhe certifikata e vdekjes është lëshuar mbi 4 vjet pas ngjarjes. Gjithashtu, arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se hetimet ishin të papërsëritshme dhe se në vitin 1997 nuk funksionin institucionet, nuk qëndron, sepse në ngjarje të tjera të asaj periudhe janë kryer ekspertime shkencore. Në rastin konkret, gjykatat kanë zhvendosur barrën e provës dhe dyshimet nuk i kanë çmuar në favor të tij.

8.3. *E drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, pasi babai i tij nuk ishte informuar përpara dhënies së dëshmisë përpara organit të akuzës dhe përpara gjykatës për të drejtën për të mos dëshmuar sipas nenit 158 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

8.4. *Proporcionaliteti i dënimit*, pasi dënimi me 21 vjet, në kushtet kur nuk ka prova të mjaftueshme, është në tejkalim të testit të proporcionalitetit dhe është jashtëzakonisht i rëndë.

8.5. *E drejta për parashkrimin e dënimit*, pasi vendimi i dënimit i gjykatës së shkallës së parë ka marrë formë të prerë në datën 24.04.2000 dhe, sipas përcaktimeve të KPP-së, ky dënim parashkruhej pas 20 vjetëve, çka bën që afati të ketë mbaruar në datën 24.04.2020, ndërsa ai është njohur me ekzekutimin e vendimit vetëm në datën 05.08.2020, pra rreth 3 muaj pas afatit. Ky fakt bën që vendimi i ekzekutuar ndaj tij të ishte parashkruar.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Në këtë këndvështrim, Kolegji vëren se kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “F” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

11. Një tjetër kriter paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Organik të Gjykatës përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuari përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

12. Kërkuari ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e *proporcionalitetit të dënimit*, pasi dënimi me 21 vjet, në kushtet kur nuk ka prova të mjaftueshme, është në tejkalim të testit të

proporcionalitetit dhe është jashtëzakonisht i rëndë. Kolegji konstaton se ky pretendim i kërkuarit nuk është ngritur as në ankim dhe as në rekurs, duke mos u shteruar në këtë mënyrë të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese, prandaj nuk mund të merret në shqyrtim.

13. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuarit, ato janë ngritur në të tria shkallët e gjyqësorit, ndaj Kolegji vlerëson se ai i ka shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, duke mos pasur mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët edhe përmes njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në çështjen konkrete, Kolegji evidenton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuari, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 18.09.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 02.04.2026. Nga ana e kërkuarit, bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, është paraqitur *e-mail*-i i Gjykatës së Lartë që i ka komunikuar atij vendimin në datën 04.12.2025, çka provon se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, për pasojë kërkuari legjitimohet *ratione temporis*.

16. Për sa i takon legjitimitit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuari ka pretenduar cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe së drejtës së mbrojtjes, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, parimit të prezumimit të pafajësisë, së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, si dhe së drejtës për parashkrimin e dënimit*.

17. Kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për parashkrimin e dënimit, pasi vendimi i dënimit të tij i gjykatës së shkallës së parë ka marrë formë të prerë në datën 24.04.2000 dhe sipas përcaktimeve të KPP-së ky dënim parashkruhej pas 20 vjetëve, çka bën që afati të ketë mbaruar në datën 24.04.2020, ndërsa ai është njohur me ekzekutimin e vendimit vetëm në datën 05.08.2020, rreth 3 muaj pas afatit. Ky fakt bën që vendimi i ekzekutuar ndaj tij të ishte parashkruar.

18. Gjykata ka theksuar se në legjislacionin penal ligjvënësi, ndër të tjera, ka parashikuar edhe rastet në të cilat vendimet gjyqësore nuk ekzekutohen. Kështu, sipas nenit

68/a të KP-së parashikohet se “Vendimi i dënimit nuk ekzekutohet kur nga dita që ka marrë formë të prerë kanë kaluar: a) njëzet vjet për vendimin që përmban dënim pesëmbëdhjetë gjer në njëzetepesë vjet burgim.”. Sipas përcaktimit të kësaj dispozite vërehet se ligjvënësi ka parashikuar në të afatet, me kalimin e të cilave, vendimi i dënimit i dhënë ndaj një personi për vepra penale të kryera prej tij nuk mund të ekzekutohet më. Nga përmbajtja e kësaj dispozite konstatohet se qëllimi i ligjvënësit ka qenë vendosja e një kufizimi kohor për organet kompetente shtetërore të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve të dënimit brenda të cilit këto organe kanë të drejtë të vënë në ekzekutim një vendim penal të formës së prerë. Duke pasur parasysh afatet e vendosura në nenin 68 të KP-së, kjo e drejtë e këtyre organeve shuhet me kalimin e këtyre afateve kohore (*shih vendimin nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin në shqyrtim, nga vendimet gjyqësore rezulton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier që e ka dënuar kërkuesin është dhënë në datën 14.04.2000, duke vendosur deklarinin fajtor të tij për veprat penale të parashikuara nga nenet 78 dhe 25, si dhe 278 paragrafi 2, të KP-së dhe dënimin përfundimisht të tij me 25 vjet burg. Ky vendim rezulton se ka marrë formë të prerë në datën 24.04.2000. Referuar nenit 68 të KP-së, parashikohet se vendimi i dënimit nuk ekzekutohet kur nga dita që ka marrë formë të prerë kanë kaluar njëzet vjet për vendimin që përmban dënim pesëmbëdhjetë gjer në njëzetepesë vjet burgim, siç është edhe rasti kërkuesit. Nga ky përcaktim rezulton se data në të cilën ekzekutimi i vendimit të dënimit për kërkuesin parashkruhej ishte më 25.04.2020. Ndërkohë mbi bazën e urdhërarrestit ndërkombëtar në vitin 2018, kërkuesi është arrestuar në Britaninë e Madhe ku jetonte dhe shteti shqiptar ka kërkuar ekstradimin e tij për të vuajtur dënimin, kundrejt garancisë për ta rigjykuar (arsye për të cilën është kërkuar në atë vit edhe rishikimi i vendimit të dënimit (*shih paragrafin 3 të vendimit*)).

20. Për këto fakte, Kolegji vëren se vendimi i formës së prerë është ekzekutuar përpara datës 25.04.2020, si datë e parashkrimit të dënimit, me arrestimin e tij për urdhërarrestin ndërkombëtar të lëshuar nga shteti shqiptar. Prandaj, duke mbajtur parasysh për sa më sipër, Kolegji çmon se arrestimi përbën edhe momentin e vënies në ekzekutim të vendimit penal të dhënë në ngarkim të kërkuesit. Për më tepër, ky konkluzion përforcohet edhe nga parashikimet e pikës 4 të nenit 504 të KPP-së ku përcaktohet se paraburgimi jashtë shtetit, si rrjedhojë e një kërkesë ekstradimi të paraqitur nga shteti shqiptar, llogaritet në masën e dënimit, sipas rregullave që normon neni 57 i KP-së. Në këtë optikë, Kolegji vlerëson se vendimi është ekzekutuar që në momentin e arrestimit të tij dhe brenda afateve ligjore të parashkrimit, për rrjedhojë ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

21. Kërkuesi gjithashtu ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe së drejtës së mbrojtjes*, pasi gjykatat nuk kanë arsyetuar edhe mbi faktin se disa dëshmi referonin në persona të tretë të cilët nuk ishin marrë kurrë në pyetje nga organi akuzës edhe pse nuk kishte pengesa objektive. Në pyetje nuk është marrë as shtetasi M.Sh. që, sipas dëshmitarëve, kishte dhënë emrat e personave që ndodheshin në makinë. Si shkelje pretendohet edhe fakti se kërkuesi nuk ishte njohur me kartën e të drejtave të tij në shkallë të parë, ndërsa apeli në shkelje të ligjit ka arsyetuar se fakti që ishte mbrojtur me avokat e kishte rregulluar këtë të metë të gjykimit. Në shkelje të nenit 378/a të KPP-së, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pas dhënies së konkluzioneve, ka revokuar vendimin për shpalljen e vendimit përfundimtar dhe ka riçelur hetimin pa kërkesë të asnjërës palë.

22. Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim kërkon krijimin e mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose të përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe për deklaratimet e tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore për çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 9 datë 27.02.2024; nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën kushtetuese Gjykata ka pranuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substanciale, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Kolegji vëren se ky pretendim i kërkuesit përbëhet në vetvete nga tre argumente të ndryshme. Lidhur me argumentin e kërkuesit se gjykatat nuk kanë arsyetuar edhe mbi faktin se disa dëshmi referonin në persona të tretë të cilët nuk janë marrë kurrë në pyetje nga organi akuzës edhe pse nuk kishte pengesa objektive, Kolegji çmon se ky argument lidhet me hetimet e prokurorisë dhe jo me të drejtën e tij të mbrojtjes e të paraqitjes së provave e të diskutimit mbi to, ndërkohë që në rigjykim, megjithëse është proceduar me gjykim të zakonshëm, nga mbrojtja e kërkuesit është thirrur të dëshmojë vetëm motra e tij, ndërsa nuk janë kërkuar të dëgjohen dëshmitarë të tjerë. Në këtë kuadër, ky argument i kërkuesit nuk qëndron.

24. Për sa i takon argumentit tjetër, se ai nuk ishte njohur me kartën e të drejtave të tij gjatë gjykimit në gjykatën e shkallë së parë, Kolegji evidenton se, ashtu sikurse ka arsyetuar gjykata e apelit, në kushtet kur kërkuesi mbrohej me avokat në gjykim, kjo e metë e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë ishte shëruar. Gjithashtu, Kolegji vëren se nga ana e kërkuesit nuk është shpjeguar sesi kjo e metë e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë ka cenuar të drejtat

e tij kushtetuese, ndaj, në këtë kontekst, ky argument i kërkuessit nuk mund të merret në shqyrtim.

25. Në argumentin e tretë të këtij pretendimi parashtrohet se në shkelje të nenit 378/a të KPP-së, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pas dhënies së konkluzioneve, ka revokuar vendimin për shpalljen e vendimit përfundimtar dhe ka riçelur hetimin pa kërkesë të asnjërës pale. Lidhur me këtë argument, nga procesverbali i seancës gjyqësore rezulton se në konkluzionet e tij prokurori kishte harruar njërën nga veprat penale (armëmbajtjen pa leje) dhe në kushtet kur ai mungonte në seancë, për të qartësuar nëse ishte lapsus apo tërheqje nga akuza, ajo gjykatë ka riçelur hetimin gjyqësor vetëm për të sqaruar këtë fakt.

26. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes të të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 5, datë 29.01.2025; nr. 30, datë 18.04.2024; nr. 30, datë 19.05.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke mbajtur parasysh sa më sipër, Kolegji vlerëson se shkelja e nenit 378/a të KPP-së nga ajo gjykatë nuk ka qenë thelbësore dhe e tillë që të ndikojë drejtpërdrejt në të drejtat dhe liritë themelore të kërkuessit, për më tepër edhe në kushtet kur riçelja nuk është bërë me qëllim marrjen e provave të reja, por vetëm të sqarimit të akuzës nga ana e prokurorit. Për sa më sipër, edhe ky argument i kërkuessit nuk qëndron dhe pretendimi i tij për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit si dhe së drejtës së mbrojtjes* është haptazi i pabazuar.

27. Kërkuessi ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, pasi babai i tij nuk është informuar përpara dhënies së dëshmisë përpara organit të akuzës dhe përpara gjykatës për të drejtën për të mosdëshmuar sipas nenit 158 të KPP-së. Lidhur me këtë pretendim, nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 03.06.2021, rezulton se në kundërshtim nga sa pretendon kërkuessi, përpara dëshmisë së babait të tij, gjykata i ka kujtuar atij të drejtën për të mos dëshmuar, ndërsa ai ka shprehur gatishmërinë për të vijuar me dëshminë e tij, ndaj edhe ky pretendim i tij është haptazi i pabazuar.

28. Kolegji vëren se kërkuessi, po ashtu, ka pretenduar edhe cenimin e parimit të *prezumimit të pafajësisë dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, të cilat bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues dhe, referuar argumenteve të dhëna, do të trajtohen në vijim të lidhura.

B. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

29. Kërkuesi ka pretenduar se dënimi i tij është mbështetur në një zinxhir indiciesh dhe thëniesh të tërthorta pa pasur asnjë provë shkencore, duke mos arritur një standard të lartë provueshmërie. Në rastin e tij, gjykatat e kanë bazuar vendimin mbi prova të tërthorta, pa burim të verifikuar, duke mos garantuar standardin e drejtësisë së procesit. Ndër të tjera, vendimet e dënimit janë dhënë në mungesë të këqyrjes së vendit të ngjarjes, këqyrjes së kufomës dhe aktekspertimit mjeko-ligjor, ekspertimit balistik dhe mosgjetjes së armës së krimit, mosqenies së asnjë dëshmitari në vendin e ngjarjes, ndërkohë që edhe certifikata e vdekjes është lëshuar mbi 4 vjet pas ngjarjes. Gjithashtu, arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se hetimet ishin të papërsëritshme dhe se në vitin 1997 nuk funksionin institucionet, nuk qëndron, sepse në ngjarje të tjera të asaj periudhe janë kryer ekspertime shkencore, çka provon të kundërtën e asaj që pretendon gjykata e shkallës së parë. Në rastin konkret, gjykatat kanë zhvendosur barrën e provës dhe dyshimet nuk i kanë çmuar në favor të tij.

30. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar edhe se nuk janë arsyetuar pretendimet për papërdorshmëri të provave për sa u takon deklarimeve të dëshmitarëve pa i analizuar ato në raport me kriteret ligjore të nenit 154 të KPP-së dhe pa u shprehur se përse këto thënie të tërthorta konsideroheshin të përdorshme. Gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar as për mosadministrimin e dosjes nr. 49/1 që ishte procedim i ndarë për personat e tjerë të cilët ishin në makinë dhe që mund të përmbante prova vendimtare për zbardhjen e çështjes. Gjithashtu, gjykatat nuk kanë arsyetuar për deklarimet e dëshmitarëve për burimin e njohjes së faktit ku ekzistojnë tre versione kontradiktore mes tyre. Të gjitha shkeljet e pretenduara nga ai nuk janë korrigjuar as nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke mos përmbushur funksionin e saj si gjykatë ligji.

31. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ndërsa neni 142, pika 1, i saj parashikon se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.

32. Gjykata ka theksuar se, në rastin e gjykimit penal, parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Ai kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për

vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 33, datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë pretendimet e kërkuarit, Kolegji do të verifikojë nëse në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuarit gjykatat e faktit dhe Kolegji Penal kanë respektuar garancitë procedurale të parimit të prezumimit të pafajësisë, që kanë të bëjnë me vlerësimin e dyshimeve në favor të kërkuarit, si dhe prezumimet ligjore dhe të faktit në përcaktimin e fajësisë së tij tej çdo dyshimi të arsyeshëm, dhe se vendimet janë të arsyetuara mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese

35. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka arsyetuar se kërkesa e organit të akuzës është e bazuar në prova e në ligj, për rrjedhojë rezulton e provuar se kërkuari ka kryer vrasjen me paramendim të viktimës. Ajo gjykatë ka arsyetuar se për të provuar paramendimin nga indiciet ka rezultuar se të dy të rinjtë njiheshin pasi kishin luajtur bilardo një muaj përpara ngjarjes dhe kjo vërtetohej edhe nga fakti që kërkuari kishte dale nga banesa në të njëjtën kohë që edhe viktimja dilte të kulloste delet. Gjithashtu, kërkuari kishte përgatitur mjetet e nevojshme për ngjarjen, si arma, automjeti të cilit i ishin hequr targat dhe bashkëpunëtorët e tij të cilët ishin të panjohur për zonën dhe do ta ndihmonin për t'u larguar. Po kështu, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe faktin se automjeti kishte ndaluar pikërisht në vendin ku viktimja kulloste bagëtitë, ndërkohë që goditja e viktimës është bërë në afërsi të gojës. Elemente të tjera provuese, sipas saj, janë edhe fakti se kërkuari është larguar menjëherë jashtë Shqipërisë,

ndërsa babai i tij ka dërguar lajm në familjen e viktimës se vrasja ishte kryer nga djali i tij si një formë për të kërkuar falje.

36. Sipas asaj gjykate, i gjithë mekanizmi i ngjarjes është provuar fillimisht nga thëniet e dëshmitarëve R.S. dhe N.H., të cilët, duke udhëtuar me kamion, janë ndeshur me kërkuesin duke e identifikuar atë dhe mjetin, si dhe duke saktësuar faktin se ata ishin të armatosur. Dëshmi tjetër provuese është ajo e dajës së viktimës që kishte mësuar nga shtetasi H.Sh. i dërguar nga babai i kërkuesit në shtëpinë e viktimës, se viktimën e kishte vrarë djali i tij, kërkuesi. Ky fakt, thekson ajo gjykatë, është provuar edhe nga thëniet e shtetasit H.Sh. që kishte bërë ndërmjetësin për të çuar fjalë për vrasjen në familjen e viktimës. Edhe dëshmia e babait të kërkuesit, që paraqet alibi gjatë deklarimeve përpara gjykatës, duke pretenduar se i është kërkuar nën kërcënim nga një person i panjohur që të deklaronte se vrasjen e kish bërë i biri, për gjykatën është e pabesueshme, pasi në kohën e ngjarjes nuk ishte bërë përpara oficerëve të Policisë Gjyqësore.

37. Lidhur me pretendimet për deklarime kontradiktore sesi ishte marrë vesh vrasja, ajo gjykatë ka arsyetuar se ky fakt lidhej me kohën e gjatë të ngjarjes. Sipas saj, është e vërtetë se asnjë nga dëshmitarët e pyetur nuk kanë qenë në vendin e ngjarjes në momentin që ka ndodhur ngjarja, pasi viktimë ka ndërruar jetë menjëherë dhe autorët e tjerë, përfshirë kërkuesin, i cili nuk dha shpjegime, u larguan nga vendi i ngjarjes. Por, sipas saj, në këtë rast, dëshmitarë nuk janë vetëm të pranishmit në vendin faktik të ngjarjes, pasi vendi i ngjarjes nuk përbëhet vetëm nga zona se ku ndodhet viktimë i shtrirë, por edhe nga një perimetër më i gjerë, ku autorët janë të dukshëm nga dëshmitarë të tjerë, sikurse në rastin konkret që ata janë shkëmbyer me automjetin ku udhëtonin R.S. dhe N.H. Ndërkohë për faktin e pranimit të autorësisë të të birit (kërkuesit) nga S.M. nuk ishte e nevojshme të kishin qenë dëshmitarët në vendin e ngjarjes, sepse F.J., B.Ç., B.B. dhe H.Sh. kanë treguar se i ati i kërkuesit u ka thënë se autori është i biri. Për sa i takon mosadministrimit të dosjes nr. 49/1, gjykata e shkallës së parë arsyeton se fakti i bashkautorësisë me persona të tjerë del i provuar nga tërësia e rrethanave dhe nuk është e nevojshme që për ata persona të pidentifikuar të përfundojnë hetimet ose jo. Lidhur me pretendimin se nuk janë thirrur e nuk janë pyetur shtetasit V.M., B.J. dhe D.Rr., ajo gjykatë thekson se nuk është vlerësuar si e nevojshme nga akuza, dhe ky organ mbron akuzën e tij përmes provave të cilat i çmon të nevojshme, ndërkohë këta shtetas nuk u kërkuar as nga vetë mbrojtja si dëshmitarë, si dhe nuk u çmua e nevojshme edhe nga vetë ajo gjykatë thirrja dhe pyetja e tyre, pasi faktet për të cilat ata kishin dijeni provohen edhe nga deklarimet e dëshmitarëve të tjerë.

38. Për mungesën e provave shkencore, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se fakti i vdekjes së viktimës dilte i provuar dhe nuk kundërshtohet nga kërkuesi dhe mbrojtësi. Këqyrja

e vendit të ngjarjes, këqyrja e kufomës, ekspertimi mjeko-ligjor i saj janë veprime të papërsëritshme dhe për shkak se procedimi penal, duke qenë ende viti i ashtuquajtur i mbrapshtë 1997, kishte nisur dy muaj më vonë sesa ngjarja, kanë qenë të pamundura për t'u realizuar. Megjithatë, mungesa e këtyre provave nuk passillte mungesën e të provuarit të faktit penal. Provat, sipas saj, nuk kanë vlerë të paracaktuar, pra prova me ekspert ose këqyrja e vendit të ngjarjes nuk ka më tepër vlerë sesa dëshmia, ose anasjelltas.

39. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm e ka konsideruar të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë për sa i takon fajësisë për kryerjen e vrasjes. Ajo gjykatë ka përsëritur shqyrtimin gjyqësor duke administruar prova si nga mbrojtja (dëshmi), ashtu edhe nga organi akuzës. Gjithashtu, është administruar edhe dëshmia e kërkuesit përpara gjykatës angleze që do të vendoste për ekstradimin, ku ai ka dëshmuar se ka udhëtuar me automjetin dhe personat që kishin kryer vrasjen, pasi nuk kishte taksë dhe se ai nuk njihej me ta. Ajo gjykatë, për kualifikimin e veprës penale, në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kërkuesi kishte kryer veprën penale të vrasjes me dashje dhe jo atë të vrasjes me paramendim, siç gabimisht kishte vlerësuar gjykata e shkallës së parë. Gjykata e apelit ka çmuar se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejt rrethanat e faktit dhe provat, veprimet aktive të kryera nga kërkuesi në raport me të gjitha faktet, provat dhe thëniet e dëshmitarëve në proces, duke i vlerësuar ato në unitet me njëra-tjetrën në drejtim të fajësisë së autorit të veprës penale, duke arritur në përfundimin se vrasja ishte kryer nga ai.

40. Për sa i takon fuqisë provuese të dëshmive të administruara, ajo gjykatë ka çmuar se gjykata e shkallës së parë ka pranuar thirrjen e dëshmitarëve të kërkuar nga organi i akuzës dhe i pandehuri, duke thirrur të gjithë dëshmitarët e nevojshëm. Për dëshmitarët që nuk janë gjetur ose nuk jetonin më është proceduar me leximet e lejueshme. Gjithashtu, edhe kur kanë rezultuar kontradikta ndërmjet dëshmive të dhëna prej dëshmitarëve, me deklaratimet e tyre të mëparshme, është proceduar me lejimin e kundërshtimit të dëshmisë dhe analiza e gjykatës, është bazuar në provat e rezultuara gjatë gjykimit, dëshmitë dhe deklaratimet e dhëna prej dëshmitarëve gjatë hetimeve paraprake. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë nuk e ka bazuar vendimin e saj në dëshminë e babait të kërkuesit, as në deklaratimet e bëra prej tij gjatë hetimit, dhe as në dëshminë e së motrës të të pandehurit E.Ç. Gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar dëshminë e tyre, duke vënë në dyshim besueshmërinë jo vetëm nga raporti i tyre me të pandehurin, por duke i ballafaquar ato me dëshmitë e personave të tjerë, të cilët kanë qenë neutralë. Gjykata e apelit konkludon se vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë është bazuar kryesisht në dëshmi neutrale nga persona që nuk kanë pasur lidhje me palët, si dhe me deklarime që janë dhënë të pandikuara nga koha e kaluar.

41. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, për pretendimet e kërkuarit ka vlerësuar se ato janë ngritur edhe në ankimin e ushtruar përpara Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e cila, pasi i ka marrë në shqyrtim, u ka kthyer përgjigje atyre, të cilat janë përsëritur edhe në rekurs. Për sa u përket pretendimeve që kanë të bëjnë me paprovueshmërinë e akuzës, ai kolegji vlerëson se gjykata e apelit, referuar rrethanave të faktit, indicieve dhe provave të vlerësuara në përputhje me nenet 151 e vijues të KPP-së, ka krijuar bindjen e brendshme se kërkuari duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprave penale “Vrasja me dashje”, të kryer në bashkëpunim, si dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje të armëve luftarake dhe i municionit”. Në përfundim, Kolegji Penal, duke vlerësuar në tërësi vendimmarrjen objekt rekursi, procesin e zhvilluar në gjykatat e faktit, verifikimin e zbatimit të garancive kushtetuese e procedurale për kërkuarin, që ka pasur të gjitha hapësirat, kohën dhe mundësinë për të realizuar një mbrojtje efektive, ka çmuar se argumentet e gjykatës së apelit janë të mjaftueshme për të mbështetur pjesën urdhëruese të vendimit të saj dhe nuk cenojnë elementet e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

42. Në parantezë të analizës së këtij argumenti, mbahet parasysh fakti se Gjykata ka theksuar që vlerësimi i provave është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për qëllime të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të shqyrtojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur vlerësimi i provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ka cenuar parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë çështja i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtyre standardeve dhe në kushtet kur mënyra e vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme është vënë në dyshim nga kërkuari, si shkak për të cilin atij i është cenuar e drejta themelore për t’u prezumuar i pafajshëm, në vijim Kolegji do të analizojë vlerësimin e provave në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuarit, në kuptimin e garancive të parimit të prezumimit të pafajësisë, pra nëse fajësia e këtij të fundit është vendosur përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe në respektim të parimit *in dubio pro reo*.

43. Duke mbajtur parasysh për sa më sipër, Kolegji vëren se nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në rigjykim janë rimarrë një sërë dëshmish, si dhe është lejuar leximi për dëshmitë të cilat nuk mund të merreshin. Nga tërësia e këtyre provave dhe indicieve është arritur në përfundimin se vrasja ishte kryer nga kërkuari, ndërsa për cilësimin e saj si vrasje me paramendim ajo gjykatë ka kryer një analizë të arsyeve, të cilat, sipas saj, vërtetohnin këtë akuzë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier gjithashtu i ka dhënë përgjigje të arsyetuar kërkuarit për të

gjitha pretendimet e tij, përgjigje këto të cilat janë konsideruar të drejta edhe nga dy gjykatat e tjera më të larta.

44. Gjykata e apelit, nga ana e saj, pasi ka marrë në analizë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe ka riçelur shqyrtimin gjyqësor, duke administruar prova të reja nga të dyja palët, ka bërë një analizë të drejtë për të provuar fajësinë e kërkuesit, pasi ka analizuar katër elementet e veprës penale duke konkluduar ndryshe nga gjykata e shkallës së parë për anën subjektive të saj. Për sa i takon vërtetimit të fajësisë, ajo gjykatë i ka vlerësuar veprimet aktive të kryera nga kërkuesi në raport me të gjitha faktet, provat dhe thëniet e dëshmitarëve në proces, duke i vlerësuar ato në unitet me njëra-tjetrën, si dhe duke analizuar edhe dëshmitë kontradiktore të kërkuesit përpara gjykatës angleze me ato të babait të tij për udhëtimin me mjetin që ishte përdorur në vrasje. Nga ana e tij, me të drejtë, Kolegji Penal ka vlerësuar se gjykatat e faktit, në përputhje me nenin 152 të KPP-së, i kanë çmuar provat në përputhje me njëra-tjetrën, duke dhënë argumente te mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e kërkuesit, ndërkohë që e ka gjetur të drejtë cilësimin juridik të bërë nga gjykata e apelit.

45. Nën këtë optikë, si dhe bazuar në përmbajtjen e argumenteve të paraqitura nga kërkuesi në mbështetje të pretendimeve të tij, Kolegji çmon se gjykatat e zakonshme, përfshirë Gjykatën e Lartë, kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave. Nga analiza e vendimeve të gjykatave të zakonshme, Kolegji vëren se nuk rezulton që çmuarja e provave ose zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme të ketë gabime faktike ose ligjore të dukshme, që t'i bëjë vendimet gjyqësore arbitrare, nuk rezulton që barra e provës t'i ketë kaluar kërkuesit, si dhe nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme. Gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin se kërkuesi ishte autor i veprës penale, duke analizuar për këtë qëllim në vendimet e tyre përmbajtjen e provave të shqyrtuara dhe duke shpjeguar sesi ato lidheshin me njëra-tjetrën, pa i dhënë ndonjëherë prej tyre vlerë të paracaktuar. Ato kanë përcaktuar fajësinë e kërkuesit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, bazuar në një mori provash, përmbajtja e të cilave është analizuar dhe arsyetuar mjaftueshëm. Gjithashtu, vendimet gjyqësore të kundërshtuara, të lexuara në tërësinë e tyre, nuk rezultojnë të paarsyetuara në atë masë që të cenojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor. Për më tepër, bazuar në vendimet gjyqësore të kundërshtuara, rezulton se gjykatat kanë marrë në shqyrtim edhe pretendimet e tjera të kërkuesit dhe u kanë dhënë përgjigje të bazuara, duke arsyetuar vendimmarrjen e tyre. Gjithashtu, vendimet gjyqësore, në tërësinë e tyre, paraqiten të rregullta në formë, të qarta, koherente dhe pa kundërthënie në përmbajtje, duke respektuar standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë lidhur me arsyetimin e vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

46. Nisur nga sa më sipër, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.